



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë më 13.11.2017

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”

(shqyrtimi në parim)

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 7.11.2017 bëri prezantimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2018”, të paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Në mbledhjen e komisionit morën pjesë ministri i Financave dhe Ekonomisë, z.Arben Ahmetaj, sekretarja e përgjithshme e ministrisë, znj.Gelardina Prodani dhe drejtoresha e Përgjithshme e Buxhetit znj.Mimoza Dhëmbi, të cilët bënë paraqitjen e projektbuxhetit për vitin 2018 para anëtarëve të Komisionit dhe iu përgjigjën pyetjeve në parim.

I. Baza kushtetuese e projektligjit, vlerësimi kushtetues dhe procedural

Propozimi i këtij projektligji vjen nga ana e Këshillit të Ministrave, në bazë të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, e 158, të Kushtetutës .

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

II. Objektivat e Buxhetit 2018

Bazuar në relacionin shoqërues, rritja ekonomike, parashikimet e rritjes ekonomike, sipas këtij projektbuxheti, kapin vlera përtej 4% bazuar në një rritje të balancuar si sektoriale ashtu dhe të kërkesës së brendshme dhe të huaj.

Defiçiti buxhetor për vitin 2018 planifikohet të jetë në nivelin 2.0% të PBB. Për të tretin vit rradhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.6% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të dytin vit radhazi. Rrjedhimisht, niveli i borxhit publik të targetuar, do të ulet me rreth 2.5 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 68.6% të PBB dhe do të vijojë këtë trend rënës në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

1. Realizimi i reformave

Projektbuxheti 2018 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për zbatimin e pesë reformave në sektorë kyç të ekonomisë: reforma e ujit, reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, reforma e menaxhimit të financave publike dhe reforma administrative-territoriale.

• Reforma e Drejtësisë

Sipas relacionit shoqërues, një nga objektivat kryesore të këtij projektbuxheti është mbështetja e zbatimit të Reformës në Drejtësi, e cila prek drejtpërdrejt sistemin gjyqësor dhe kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi. Gjatë vitit 2017, Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar një sërë ligjesh si pasojë e reformimit të Sistemit të Drejtësisë. Po gjatë vitit 2017, janë zgjedhur të gjithë organet e rivlerësimit kalimtar - Anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimeve - Komisionerët Publikë - Anëtarët e Komisionit të Posaçëm të Apelitit Gjatë vitit 2017, Qeveria Shqiptare ka realizuar rikonstruktimin e ndërtesës së ish “Lidhjes së Shkrimtareve”, godine e cila do të shërbejë për akomodimin e stafit sipas strukturës përkatëse të dy Komisioneve për procesin e Rivlerësimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjithashtu, Kuvendi është duke përzgjedhur dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe kanë filluar procedurat edhe për organet e tjera të sistemit të qeverisjes së drejtësisë.

Mirëfunksionimi i institucioneve ekzistuese si dhe krijimi i organeve të reja të drejtësisë sjellin detyrime për parashikime buxhetore në drejtim të:

- Krijimit dhe ngritjes së kapaciteteve të KLGJ, KLP dhe inspektoratit përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Krijimit të strukturave të specializuara anti-korrupsion në nivel kombëtar
- Krijimit të një platforme të IT për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit;
- Vendosjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve të gjykatave në efikasitet të plotë;
- Krijimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve;
- Thellimit dhe zgjerimit të objektit të aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me trajnimin fillestar dhe trajnimin e vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët
- Rritjes së kapaciteteve të Departamentit të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë;
- Projektimit dhe zbatimit të sistemeve të menaxhimit, aktiviteteve operacionale dhe të kontrollit, dhe funksionimi financiar i Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera

(KLGJ, KLP, Inspektoriati i ri, Këshilli i Emërimeve) për të mundësuar që ato të menaxhojnë procesin e reformës.

• **Reforma Administrative-Territoriale**

Buxheti vendor i vitit 2018, do të shoqërohet me një model të ndryshimit të financimit dhe menaxhimit financiar në qeverisjen vendore, në funksion të thellimit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

Arritjet kryesore të kësaj reforme të shoqëruara me efekte pozitive në buxhetin vendor, do të jenë në drejtim të:

- Rritjes së transfertës së pakushtëzuar në 16.5 miliardë lekë, nga 13.5 miliardë lekë që ishte në buxhetin e vitit 2017, pra 3 miliardë lekë më shumë (ose rreth 22 % më e lartë) se në vitin 2017.
- Rritjes së të ardhurave nga burimet e veta vendore me rreth 2 miliardë lekë më shumë se plani i vitit 2017.
- Reformimit të taksës së pronës nëpërmjet një taksimi sa më të drejtë me objektiv rritjen e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Rritjes së buxhetit në tërësi për pushtetin vendor, nga 2.1 për qind të PBB-së që zinte para reformës në 2.8 për qind të PBB-së në projekt-buxhetin e vitit 2018.
- Uljes së kostove për qytetarët, duke qenë se fragmentarizimi i njësive vendore kishte një kosto të konsiderueshme. Këto kursime do të rrisin fondin për investime publike.
- Përmirësimit të procesit të decentralizimit të financave publike;
- Rritjes së efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor, duke patur administrim dhe qeverisje më të mirë.
- Zhvillimit ekonomik lokal dhe në uljen e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Nxitjes së zhvillimit vendor, ndërkohë që ndarja territoriale para reformës shoqërohej me një ngadalësim në zhvillimin vendor, për shkak të varësisë së njësive të vetëqeverisjes vendore ndaj të ardhurave nga buxheti i shtetit.
- Rritjes së cilësisë dhe modernizimit të shërbimeve publike në nivel të qeverisjes vendore, bazuar në standardet evropiane;
- Rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin;
- Menaxhimit më të mirë të shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët.
- Forcimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale dhe krijimin e një balance midis autonomisë dhe disiplinës fiskale.

• **Reforma e Administratës Publike**

Strategjia Ndërsektorale e Reformës së Administratës Publike 2015-2020 fokusohet mbi zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit,

menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm, promovimin e etikës në administratën publike, si dhe garantimin e qeverisjen elektronike.

Disa nga objektivat e projektbuxhetit në drejtim të reformës në administratën publike janë:

- Ndjekja e procesit të reformimit dhe ristrukturimit të institucioneve të varësisë;
- Forcimi i kapaciteteve të Departamentit të Administratës Publike dhe njërive të burimeve njerëzore;
- Zbatimi i mëtejshëm i vendimeve gjyqësore të formës së prerë
- Zhvillimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Forcimi i vazhdueshëm dhe fuqizimi i ASPA si institucioni qendror i trajnimit dhe kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve në fushën e administratës publike.

2. Buxheti Vendor

Buxheti Vendor, për herë të parë, si rezultat i zbatimit të ligjit të ri “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i miratuar në prill të këtij viti, do të transferohet në nivel vendor 2 për qind e tatimit mbi të ardhurat personale. Gjithashtu, transferta e pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore vetëm sipas këtij ligj do të jetë jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto, e cila në vlerë nominale përbën një rritje me rreth 3 miliardë lekë. Të ardhurat e njërive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2018 pritet të jenë

9% më të larta se ato të vitit 2017 kryesisht bazuar në përmirësimin e taksës mbi pronën. Pritshmëria është që kjo rritje e të ardhurave të shkojë e tëra në rritjen e investimeve publike të bashkive dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përmes kësaj rritjeje do të synohet forcimi i decentralizimit fiskal, konsolidimi fiskal dhe financiar dhe orientimi i qeverisjes vendore brenda një kuadri të qartë qëndrueshmërie dhe zhvillimor.

Në buxhetin e vitit 2018, shuma e transfertës së pakushtëzuar e shpërndarë me anë të formulës rritet në 16.5 miliardë lekë, nga 13.5 miliardë lekë që ishte në buxhetin e vitit 2017, pra 3 miliardë lekë më shumë (ose rreth 22 % më e lartë) se në vitin 2017. Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar krahasuar me një vit më parë, tregon rëndësinë që ky buxhet i kushton procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore në zbatim të Reformës Administrativo - Territoriale.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA LIDHUR ME PROJEKTBUXHETIN NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE

Gjatë prezantimit të projektbuxhetit në Komision, Ministri i Financave. z..Arben Ahmetaj informoi deputetët se projektbuxheti 2018 financon reforma të rëndësishme, siç është edhe reforma në drejtësi.

Për sa i takon financimit të kësaj reforme, buxheti i vitit 2018 mbështet krijimin e një inspektorati të vetëm të pavarur, përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve; rritjen e funksionimit të KLGJ-së; krijimin e KLP-së dhe ngritjen e kapaciteteve; krijimin e një strukture të specializuar antikorrupsion në nivel kombëtar, i përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykata; krijimin e një platforme IT-je për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit; vendosjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve të gjykatave në efikasitet të plotë; krijimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedimin e çështjeve “MLA” me Ministrinë e Drejtësisë në vazhdim dhe përfshirjen e Prokurorisë së Përgjithshme në sistemin e mësipërm të menaxhimit.

Në vitin 2018, informoi ministri, është vendosur në funksion të reformës në drejtësi mbi 1 miliardë lekë, pra rreth 1,3 miliardë lek.

Në vazhdim të diskutimit në Komision, ministri Ahmetaj iu përgjigj pyetjeve të deputetëve lidhur me parashikimet e buxhetit për disa fusha, si në investimet publike në rrugë, turizëm, bujqësi, si dhe për administrimin e taksës vendore nga pushteti vendor.

Pas përfundimit të pyetjeve dhe diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët e Komisionit, si dhe përgjigjeve të dhëna, **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shumicën e votave të anëtarëve, miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2018”, duke konstatuar se:**

- Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën, nenet 78, 83, pika 1 dhe 158 të saj;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni i Ligjeve, në përputhje me afatet e përcaktuara Kalendarin e Kuvendit sipas nenit 79 të Rregullores për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit të Vitit 2018, dhe bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, e paraqet këtë raport në Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

RELATORË

Bashkim FINO

Bledi ÇUÇI

KRYETARI

Ulsi MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë 22.11.2017

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E SHETIT TË VITIT 2018”
(shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjet e datave 7, 8 dhe 22 nëntor 2017, bëri prezantimin nen për nen të projektligjit “Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2018” si dhe zhvilloi seanca dëgjimore me institucionet shtetërore, kushtetuese dhe të pavarura, sipas fushës së veprimtarisë së tij, konkretisht me:

Ministrinë e Drejtësisë,
Ministrinë e Punëve të Brendshme (Gjendja Civile, Çështjet Vendore dhe Prefekturat)
Presidencën
Prokurorinë e Përgjithshme,
Zyrën e Administrimit të Buxhetit të Pushtetit Gjyqësor,
Këshillin e Lartë të Drejtësisë,
Gjykatën Kushtetuese,
Avokatin e Popullit,
Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,
Shkollën e Magjistraturës,
Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi,
Autoritetin Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit
Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit
Komisionin e Pavarur të Kualifikimit
Kolegjin e Posaçëm të Apelimit
Komisionerët Publikë

Pas prezantimeve që bënë titullarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve shtetërore, Komisioni konstatoi se:

▪ **Për projektbuxhetin e Ministrisë së Drejtësisë**

Prezantimi i projektbuxhetit për ministrinë Drejtësisë u bë nga Ministri i Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj.

Lidhur me prioritetet e projekt-buxhetit 2018, Ministria e Drejtësisë, midis të tjerave, do të jetë e fokusuar në:

- Mbështetjen e zbatimit të Reformës në Drejtësi, e cila prek drejtpërdrejt sistemin gjyqësor dhe kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi.

- Rritjen e aksesit të publikut në legjislacionin e konsoliduar, përmes përmirësimit të procesit të publikimit dhe njohjes së legjislacionit Shqiptar dhe Njoftimeve Zyrtare Shqiptare.

- Realizimin dhe bashkërendimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë.

- Përmirësimin e kushteve të jetesës të të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit për arritjen e standardeve evropiane në trajtimin e këtyre kategorive.

- Ndërmarrjen e masave me qëllim konsolidimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror në shërbim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të tij;

- Forcimin dhe përmirësimin e kontrollit dhe monitorimit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Përbarimit.

- Rritjen e efikasitetit të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, përmes rritjes së kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të kuadrit ligjor.

Gjatë diskutimit në Komision znj. Gjonaj kërkoi që të korrigjohet numri i punonjësve të ministrisë, me një shtesë prej 25 punonjësish, si dhe fondi përkatës i pagave.

Në përfundim, Komisioni, pas rakordimit dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, miratoi shtesën për 25 punonjës për Ministrinë e Drejtësisë, si dhe fondin e nevojshëm të shtesës për paga, në vlerën 20 milionë lekë.

Gjithashtu, Komisioni për Çështjet Ligjore, gjatë diskutimit të projektbuxhetit nen për nen, rekomandoi që në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë duhet të parashikohet dhe një fond shtesë për ndihmën juridike, pasi ligji i ndihmës juridike parashikohet të hyjë në fuqi dhe të fillojë zbatimin në 1 qershor 2018.

▪ **Për projektbuxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për pjesën e gjendjes civile, çështjet vendore dhe prefekturat**

Në mbledhjen e Komisionit, për të paraqitur projektbuxhetin e viti 2018, mori pjesë zv.Ministri i Punëve të Brendshme, znj. Rovena Voda. Në projektligjin e buxhetit të vitit 2018 Ministria e Brendshme ka në përbërje të saj pesë programe buxhetore, nga shtatë që

ka pasur në vitin buxhetor të vitit 2017, të cilat janë ndarë në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, planifikim – menaxhim - administrim, prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor si dhe Gjendja Civile. Programi “Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor”, ka në përbërje 24 njësi shpenzuese, ku përfshihen 12 prefektura dhe 12 këshillat e qarqeve.

Programi “Gjendja Civile” ka në përbërje 61 njësi shpenzuese ku përfshihen njësitë e qeverisjes vendore për buxhetin e deleguar nga zyrat e gjendjes civile.

Buxheti total i Ministrisë së Brendshme është 21,1 miliardë lekë dhe financimi i brendshëm në buxhetin e vitit 2018 të Ministrisë së Brendshme është ai zë që zë peshën kryesore.

▪ **Për projektbuxhetin e Presidencës**

Sipas projektbuxhetit për vitin 2018, për këtë institucion është parashikuar në total buxheti prej 217.5 milionë lekësh, me një rritje prej 3.1% nga viti buxheti i vitit 2017.

Në seancën e zhvilluar në Komision, nga përfaqësuesit e Presidencës u kërkua:

- Shtesë 40 milion lekë në zërin shpenzime operative (aktivitete-ceremoniali);
- Shtesë 12 milion lekë në zërin investime (rinovim sistemi i monitorimit me kamera sigurie;
- Blerje 2 automjete, në vlerën 7 milion lekë.

Komisioni i Ligjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e këtij institucioni, miratoi kërkesën për 20 milion lekë për shpenzime operative, si dhe 10 milion lekë investime, për rinovimin e sistemit të kamerave.

▪ **Për projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dëgjoji kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme për buxhetin e vitit 2018.

Nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme u kërkua;

- Shtesë 58 punonjës ;
- Shtesë në zërin shpenzime operative për faturat e papaguara (ekspertiza mjekësia ligjore, mbrojtja kundër zjarrit) Problemi i pagesës së këtyre faturave është një problem i përsëritur prej vitesh, për shkak të detyrimit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore që këto shërbime midis institucioneve buxhetore të kryhen me pagesë.

Lidhur me kërkesat për buxhetin e vitit 2018, Komisioni vlerësoi se për shkak se ky institucion është në proces ndryshimesh si pasojë e reformës në drejtësi, kërkesat do të trajtohen në një periudhë të mëvonshme.

▪ **Për projektbuxhetin e pushtetit gjyqësor**

Buxheti i propozuar për vitin 2018 për zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, është 2,286 miliardë lekë.

Përfaqësuesit e ZABGJ-së gjatë prezantimit të projektbuxhetit të vitit 2018 kërkuan që Komisioni të marrë parasysh kërkesën për:

- 72 punonjës shtesë, nga të cilët 20 ndihmësgjyqtarë, 20 koordinatorë me publikun dhe 32 sekretare/nëpunës gjyqësorë.

-Për zërin investime të paktën të ruhet i njëjti nivel me vitin 2017, pra të ketë një shtesë prej 10 milionë lekësh.

-Në shpenzime operative kërkohet një shtesë 92 milion lekë, nga të cilat 13 milion lekë për mirëmbajtjen e sistemit të regjistrimit audio.

Lidhur me kërkesën e paraqitur nga ZABGJ për rritje të numrit të punonjësve dhe shpenzime personeli, nga përfaqësuesit e ministrisë së financave u sqarua se për reformën në drejtësi është parashikuar një buxhet shtesë. Prandaj dhe disa nga kërkesat e paraqitura nga ZABGJ për këto shtesa nuk duhet të lidhen me reformën, pasi për të ka një parashikim buxhetor më vete.

Në përfundim, Komisioni miratoi dhe vendosi t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë një shtesë 10 milion lekë investime, si dhe shtesë 22 milionë lekë shpenzime operative, pasi në projektbuxhetin 2018 shpenzimet operative janë më të vogla se faktiku 2017.

▪ **Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

Buxheti i propozuar për vitin 2018 për Këshillin e Lartë të Drejtësisë është 93 milionë lekë, dhe parashikon një rritje me 0,45 % kundrejt buxhetit të miratuar për vitin 2017.

Këshilli i Lartë të Drejtësisë, në shkresën zyrtare drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe në seancën dëgjimore seancë dëgjimore, është shprehur se fondet buxhetore për këtë institucion plotësojnë kërkesat për një funksionim normal të punës në arritjen e objektivave për vitin 2018, deri në krijimin e institucionit të ri.

▪ **Për projektbuxhetin e Gjykatës Kushtetuese**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, i cili për projektbuxhetin e vitit 2018 për këtë institucion kërkoi që të merren parasysh kërkesat për:

-10 punonjës shtesë +fond pagash (për njësinë e shërbimit ligjor dhe specialistë);

- - Për zërin shpenzime operative kërkohen 9 milionë lekë shtesë për mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve, trajnime, dhe aktivitete;

-Në zërin shpenzime për transfertë korrente të huaja (605) kërkohet shtesë prej 500 mijë lekësh për anëtarësimin në institucione ndërkombëtare;

-Në zërin investime, kërkohet një shtesë prej 17 milionë lekë, për përfundimin e projektit të informatizimit dhe dixhitalizimit të vendimmarrjes së gjykatës, për fondin e bibliotekës. për pajisje zyre dhe gjenerator, si dhe për blerje automjeti.

Lidhur me kërkesën e paraqitur për rritje të numrit të punonjësve për njësinë e shërbimit ligjor, e argumentuar me fillimin e zbatimit të reformës në drejtësi, në Komision, nga përfaqësuesit e ministrisë së financave, u sqarua se shtesat të tjera janë të parashikuara në buxhetin e veçantë për reformën në drejtësi.

Në përfundim, për këtë institucion, Komisioni vendosi të miratojë dhe t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë:

- **4 milion lekë shtesë për shpenzime operative;**
- **7 milion lekë investime, të ndara në:**
 - 1 milion lekë *fondi i bibliotekës;*
 - 1 milion lekë *pajisje zyre;*
 - 5 milion lekë *blerje automjetesh.*

▪ **Për projektbuxhetin e Avokatit të Popullit:**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, e cila lidhur me projektbuxhetin e këtij institucioni paraqiti kërkesat si më poshtë:

- 5 milionë lekë shtesë shpenzime operative;
- 3 punonjës shtesë për një strukturë të re (departament ligjor)

Shtesa në shpenzimet operative u argumentua me mbulimin e shpenzimeve për funksionimin e institucionit, pas përfundimit të projektit mbështetës të qeverisë daneze për institucionin e Avokatit të Popullit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës të miratojë një shtesë 2 milionë lekë në zërin shpenzime operative, për këtë institucion.

▪ **Për projektbuxhetin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**

Në seancën e zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore, përfaqësuesja e ILDKPKI-së, prezantoi kërkesat e këtij institucioni për projektbuxhetin 2018.

Përfaqësuesja e ILDKPKI-së paraqiti kërkesën për një shtesë të fondit të pagave në vlerën 4 milionë lekë (për orët shtesë të grupit të punës për rivlerësimin kalimtar). Kërkesa për shtesë në fondin e pagave u argumentua me detyrat e reja që ka ky institucion në zbatim të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Komisioni, vendosi të miratojë dhe t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë shtesën prej 4 milionë lekësh për fondin e pagave për këtë institucion.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Kryetari e KQZ-së, i cili paraqiti kërkesat e institucionit, si më poshtë:

Në zërin investime kërkohen:

1. Rikonstruksioni i magazinës së bazës materiale në Lundër, në vlerën 28.7 milionë lekë.
2. Përmirësimi i sistemit elektronik të ruajtjes së informacionit në vlerën 51.6 milionë lekë.
3. Shtesë kati dhe ndërtim ambiente pune afërsisht 18.2 milionë lekë.
4. Blerje dy automjete të reja, afërsisht 9.7 milionë lekë.

Komisioni, lidhur me kërkesat e këtij institucioni vlerësoi që duhet të shikohen së bashku me kostot që do të sjellin dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor, në kuadrin e reformës zgjedhore.

▪ **Për projektbuxhetin e Shkollës së Magjistraturës**

Në mbledhjen e Komisionit morën pjesë përfaqësues nga Shkolla e Magjistraturës të cilët paraqitën kërkesat e tyre lidhur me projektbuxhetin e vitit 2018. Koncretisht për këtë institucion u paraqitën këto kërkesa:

1. Shtesë 4 punonjës (fondi i pagave 5 790 000 lekë)
2. Në zërin shpenzime operative 29 500 000 lekë për realizimin e 100 sesioneve trajnuese;
3. Në zërin shpenzime kapitale shtesë për blerje autoveturë (5 milion lekë)
4. Në zërin 606 (transfera te individit) shtesë 16 810 000 lekë për shpërblimin e 16 kandidatëve magjistratë, ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve

Kërkesat e paraqitura nga ky institucion u argumentuan me detyrat e reja që përcaktohen për Shkollën e Magjistraturës nga disa prej ligjeve të reformës në drejtësi. Është thelbësor roli i Shkollës së Magjistraturës në fillimin e zbatimit të ligjit për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe detyrimet sipas këtij ligji do të sjellin rritje të volumit të punës dhe transformim të ndjeshëm të veprimtarisë së këtij institucioni.

Në përfundim Komisioni vendosi të miratojë dhe t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë për këtë institucion, shtesat si më poshtë:

1. Shtesë 1 pedagog+ 3 punonjës staf i brendshëm (të ndryshojë shtesa që është bërë në projektbuxhet për dy pedagogë) dhe fondi përkatës i pagave;
2. Në zërin shpenzime operative shtesa 24 milionë lekë, nga të cilat:
 - 14 milion lekë shtesë për bursat;
 - 10 milion lekë shpenzime të tjera operative për trajnime.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Pranvera Strakosha, e cila u shpreh se parashikimet e projektbuxhetit për vitin 2018 janë në përputhje me kërkesat buxhetore të paraqitura nga ky institucion dhe që kërkoi vetëm të korrigjohet fondi i pagave për një shtesë 3.7 milion lekë.

Komisioni vendosi të reflektohet shtesa për fondin e pagave për këtë institucion, në vlerën 3.7 milionë lekë.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Komisioni u njoh me kërkesën e paraqitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z. Besnik Dervishi, i cili paraqiti kërkesë për:

1. Shtesë prej 10 milion lekësh për organizimin në Tiranë të Konferencës Europiane;
2. Shtesë 5 milion për shpenzime operative (602);
3. 4 milion lekë shtesë për pajisje zyre;
4. Shtesë 5 milion lekë në investime për godinën(231);
5. Shtesë strukture për dy punonjës.

Në përfundim Komisioni vendosi të miratojë dhe t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë për këtë institucion, një shtesë prej 8 milion lekësh për Konferencën Europiane, si dhe shtesë 5 milion lekë në investime për godinën.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Komisioni u njoh me prezantimin e projektbuxhetit nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, znj. Irma Baraku, e cila theksoi se parashikimet e projektbuxhetit të vitit 2018 janë bërë në përputhje me tavanet e miratuara për institucionin, por për realizimin e funksioneve janë të nevojshme dhe disa shtesa në buxhet, dhe konkretisht kërkoi një shtesë 3 punonjës për zyrat lokale të Komisionerit. Komisionerja shpjegoi se më parë fondi i pagave për këta punonjës është mbuluar nga fondet IPA të Bashkimit Europian.

Komisioni, pasi vlerësoi kërkesat e këtij institucioni, duke qenë se vitin e kaluar ka pasur një shtesë prej tre punonjësish që nuk është bërë aktive, vendosi t'i rekomandojë komisionit përgjegjës që këta punonjës dhe fondi përkatës i pagave të kalojnë në zyrat rajonale.

▪ **Për projektbuxhetin e Autoritetit Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**

Kryetarja e Autoritetit gjatë seancës dëgjimore në Komision paraqiti kërkesat si vijon:

-Kërkesë për shtesë punonjësish, sipas strukturës së miratuar nga Kuvendi. Aktualisht ka 20 punonjës, ndërkohë që në strukturë janë parashikuar 60.

-Shtesë në zërin shpenzime operative 5 milion lekë (sensibilizim për veprimtarinë e Autoritetit, trajnime)

-Kërkesë në zërin investime në total 230 260 000 lekë, nga të cilat, për rikonstruksionin e godinës 142 517000 lekë, 4 491 000 lekë për projektin dhe 280 000 lekë për oponencë; Për dixhitalizimin e fondit kërkohen 37 800 000 lekë; Për investime për aparat për lexues mikrofilmash, 120 000 lekë.

Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi kërkesën e këtij institucioni për shtesë fondi në zërin investime, për rikonstruksionin e godinës, në vlerën 30 milion lekë, duke i rekomanduar Ministrisë së Financave që të shikohet mundësia për shtesë tjetër gjatë vitit me Aktin Normativ.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

Përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë seancës dëgjimore në komision paraqitën kërkesat për shtesë në shpenzime në nivelin 17 milion lekë si vijon:

-7.000.000 lekë për blerje pajisje elektronike;

-9.000.000 lekë për orendi dhe pajisje zyre;

-1.000.000 lekë për mobilim zyre dhe ambiente pune.

Komisioni, pasi vlerësoi kërkesat e këtij institucioni, miratoi dhe vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës kërkesat për shtesë në vlerën 15 milion lekë, të ndara si më poshtë:

- Orendi dhe pajisje zyre dhe mobilimi, shtesë 9 milion lekë;

- Blerje pajisje elektronike shtesë 6 milion lekë.

▪ **Për projektbuxhetin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

Përfaqësuesit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjatë seancës dëgjimore në komision paraqitën kërkesat për shpenzime kapitale shtesë në masën 45 milion lekë të detajuara si më poshtë:

-Punime rikonstruksioni në vlerën 4 milion lekë.

- Plotësim i nevojave të institucionit me kompjutera, skaner printera, sisteme elektrike në vlerën 10 milion lekë.
- Pajisje dhe mobilje për zyra në vlerën 11 milion lekë.
- Sistem regjistrimi audio-video, regjistrim audio i seancës gjyqësore në vlerën 6 milion lekë.
- Sistem kontrolli dhe vëzhgimi elektronik 4 milion lekë.
- Software për menaxhimin e çështjeve 4 milion lekë.
- Automjet për plotësimin e nevojave për lëvizje administrative në vlerën 3 milion lekë.
- Gjenerator elektrik 3 milion lekë.

Komisioni, për Çështjet Ligjore pasi vlerësoi kërkesat e këtij institucioni, miratoi dhe vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës shtesën në shpenzime kapitale, në vlerën 30 milion lekë, të ndara si më poshtë:

- Punime rikonstruksioni shtesë fondi 4 milion lekë;
- Pajisje kompjuterike shtesë fondi 8 milion lekë;
- Pajisje mobilimi dhe zyre shtesë fondi 8 milion lekë;
- Sisteme regjistrimi audio-video, regjistrim audio i seancës gjyqësore shtesë fondi 5 milion lekë;
- Software shtesë fondi 5 milion lekë.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerëve Publikë**

Komisionerët Publikë gjatë seancës dëgjimore në komision paraqitën kërkesat për shtesë në zërin shpenzime kapitale, në masën 20 milion lekë, nga të cilat:

- Punime rikonstruksioni në vlerën 2 milion lekë.
- Plotësim i nevojave të institucionit me kompjutera, skaner, printera, sisteme elektrike në vlerën 7 milion.
- Pajisje dhe mobilje për zyra në vlerën 6 milion lekë.
- Software për menaxhimin e çështjeve në vlerën 2 milion lekë.

Komisioni, për Çështjet Ligjore pasi vlerësoi kërkesat e këtij institucioni, miratoi dhe vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës shtesën në shpenzime kapitale, në vlerën 10 milion lekë, të ndara si më poshtë:

- Punime rikonstruksioni në vlerën 0.5 milion lekë.
- Pajisje elektronike shtesë fondi prej 3.5 milion lekë
- Pajisje zyre dhe mobilimi shtesë prej 4 milion lekë
- Software shtesë fondi 2 milion lekë.

▪ **Për projektbuxhetin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit**

Në Komision u paraqit Drejtori i Institutit, z.Agron Tufa, i cili pranoi se në përgjithësi projektbuxheti i vitit 2018 i ka plotësuar pritshmëritë e këtij instituti, duke kërkuar vetëm një shtesë të numrit të punonjësve me 5 (pesë) punonjës shtesë, për sektorin e arkivës.

Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi dhe i rekomandon komisionit përgjegjës që për këtë institucion shpenzimet të jenë në nivelin e vitit 2017, 13 milionë lekë, si dhe të bëhet aktive shtesa prej 4 punonjësish që është miratuar vitin e kaluar.

Të gjitha ndryshimet e miratuara më sipër nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të reflektohen në tabelën 1.1 të projektligjit.

PËRFUNDIM

Në përfundim të të gjitha shqyrtimeve, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar domosdoshmërinë për garantimin e mirëfunksionimit të organeve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, u shpreh dakord për miratimin e projektligjit “Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2018”, nën për nen, dhe në tërësi.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në përputhje me afatet e përcaktuara në kalendarin e Kuvendit sipas nenit 79 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të Shtetit të Vitit 2018, e paraqet këtë raport në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, si dhe në seancën plenare.

(Bashkëlidhur tabela përmbledhëse me kërkesat e miratuara nga Komisioni)

RELATORË

Bashkim FINO

Bledar ÇUÇI

KRYETARI

Ulsi MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

TABELA
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2018”

| N r | INSTITUCION ET | KËRKESAT E INSTITUCIONEVE | TË MIRATUARA NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE |
|------------|----------------------------------|---|--|
| 1 | Ministria e Drejtësisë | Kërkon që të korrigojohet numri i punonjësve me një shtesë prej 25 punonjësish. | Komisioni miraton dhe i rekomandon komisionit përgjegjës që kërkesa të reflektohet nga Ministria e Financave. Fondi i nevojshëm për paga për 25 punonjës, është 20 milionë lekë. |
| 2 | PRESIDENCA | -Shtesë 40 milion lekë në zërin shpenzime operative (aktivitete-ceremoniali); -Shtesë 12 milion lekë në zërin investime (rinovim sistemi i monitorimit me kamera sigurie; -Blerje 2 automjete, në vlerën 7 milion lekë. | Komisioni i Ligjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e këtij institucioni, vendosi që të vlerësojë <u>kërkesën për 20 milion lekë</u> për shpenzime operative, si dhe <u>10 milion lekë</u> për rinovimin e sistemit të kamerave. |
| 3 | Prokuroria e Përgjithshme | -Shtesë 58 punonjës; -Shtesë në zërin shpenzime operative për faturat e papaguara (ekspertiza mjekësia ligjore, mbrojtja kundër zjarrit) | Për shkak se ky institucion është në proces ndryshimesh si pasojë e reformës në drejtësi kërkesat do të trajtohen në një periudhë tjetër. |
| | | | Komisioni miratoi kërkesën për: |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | Zyra e Administrimit të Buxhetit të Pushtetit Gjyqësor | <ol style="list-style-type: none"> 1. 72 punonjës shtesë, nga të cilët 20 ndihmësgjyqtarë, 20 koordinatorë me publikun dhe 32 sekretare/nëpunës gjyqësorë. 2. Për zërin investime të paktën të ruhet i njëjti nivel me vitin 2017, pra të ketë një shtesë prej 10 milionë lekësh. 3. Në shpenzime operative kërkohet një shtesë <u>92 milion lekë</u>, nga të cilat 13 milion lekë për mirëmbajtjen e sistemit të regjistrimit audio. | <ul style="list-style-type: none"> ▪ 10 milion lekë investime; ▪ 22 milionë lekë shpenzime operative (602) <p>pasi në projektbuxhetin 2018 shpenzimet operative janë më te vogla se faktiku 2017.</p> |
| 5 | Avokati i Popullit | <p>-5milionë lekë shtesë shpenzime operative;</p> <p>- 3 punonjës shtesë për një strukturë të re (departament ligjor)</p> | <p>Komisioni miratoi kërkesën për 2 milionë lekë shtesë për zërin shpenzime operative (zëri 602).</p> |
| 6 | Gjykata Kushtetuese | <p>-10 punonjës shtesë +fond pagash (për njësinë e shërbimit ligjor dhe specialistë);</p> <p>- Për zërin shpenzime operative kërkohen 9 milionë lekë shtesë për mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve, trajnime, dhe aktivitete;</p> <p>-Në zërin shpenzime për transferata korrente të huaja (605) kërkohet shtesë prej 500 mijë lekësh për anëtarësimin në institucione ndërkombëtare;</p> <p>-Në zërin investime, kërkohet një shtesë prej 17 milionë lekë, për përfundimin e projektit të informatizimit dhe dixhitalizimit të</p> | <p>Komisioni miratoi kërkesat për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 4 milion lekë shtesë për shpenzime operative; ▪ 7 milion lekë investime, të ndara në: <i>-1 milion lekë fondi i bibliotekës;</i> <i>-1 milion lekë pajisje zyre;</i> <i>-5 milion lekë blerje automjesh.</i> |

| | | | |
|----|---|--|---|
| | | vendimmarrjes së gjykatës, për fondin e bibliotekës. për pajisje zyre dhe gjenerator, si dhe për blerje automjeti. | |
| 7 | ILDKPKI | Shtesë në fondin e pagave dhe kontribute në vlerën 4 milionë lekë (për orët shtesë të grupit të punës për rivlerësimin kalimtar) | Komisioni miratoi kërkesën për shtesë në fondin e pagave në vlerën 4 milionë lekë. |
| 8 | Ministria e Brendshme(gjendja civile, prefekturat) | - | |
| 9 | Autoriteti Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit | <p>-Kërkesë për shtesë punonjësish, sipas strukturës së miratuar nga Kuvendi. Aktualisht ka 20 punonjës, ndërkohë që në strukturë janë parashikuar 60.</p> <p>-Shtesë në zërin shpenzime operative 5 milion lekë (sensibilizim për veprimtarinë e Autoritetit, trajnime)</p> <p>-Kërkesë në zërin investime në total 230 260 000 lekë, nga të cilat:</p> <p>1.Për rikonstruksionin e godinës 142 517000 lekë për rikonstruksionin, 4 491 000 lekë për projektin dhe 280 000 lekë për oponencë;</p> <p>2. Për dixhitalizimin e fondit kërkohen 37 800 000 lekë;</p> <p>2. Për investime për aparat për lexues mikrofilmash, 120 000 lekë;</p> | Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi kërkesën e këtij institucioni për shtesë fondi në zërin investime, për rikonstruksionin e godinës, në vlerën 30 milion lekë , duke i rekomanduar Ministrisë së Financave që të shikohet mundësia për shtesë tjetër gjatë vitit me Aktin Normativ. |
| 10 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | <p>Në zërin investime kërkohen:</p> <p>1. Rikonstruksioni i magazinës së bazës materiale në Lundër, në</p> | Lidhur me kërkesat e këtij institucioni u vlerësua që duhet të shikohen së bashku me kostot që do të sjellin dhe ndryshimet |

| | | | |
|--------|--|---|---|
| | | <p>vlerën <u>28.7 milionë lekë.</u></p> <p>2. Përmirësimi i sistemit elektronik të ruajtjes së informacionit në vlerën <u>51.6 milionë lekë.</u></p> <p>3. Shtesë kati dhe ndërtim ambiente pune afërsisht <u>18.2 milionë lekë.</u></p> <p>4. Blerje dy automjete të reja, afërsisht <u>9.7 milionë lekë.</u></p> | në Kodin Zgjedhor, në kuadrin e reformës zgjedhore. |
| 1 1 | Shkolla e Magjistraturës | <p>1. Shtesë 4 punonjës (fondi i pagave 5 790 000 lekë)</p> <p>2. Në zërin shpenzime operative 29 500 000 lekë për realizimin e 100 sesioneve trajnuese;</p> <p>3. Në zërin shpenzime kapitale shtesë për blerje autoveturë (5 milion lekë)</p> <p>4. Në zërin 606 (transfera te individi) shtesë 16 810 000 lekë për shpërblimin e 16 kandidatëve magjistratë, ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve</p> | <p>Miratohet kërkesa për :</p> <p>1.Shtesë 1 pedagog+ 3 punonjës staf i brendshëm (të ndryshojë shtesa që është bërë në projektbuxhet për dy pedagogë) dhe fondi përkatës i pagave;</p> <p>2. Në zërin shpenzime operative shtesa 24 milionë lekë, nga të cilat:</p> <p>- 14 milion lekë shtesë për bursat;</p> <p>- 10 milion lekë shpenzime të tjera operative për trajnime.</p> |
| 1 2 | Komisioneri për të Drejtën e Mbrojtjen e të Dhënave Personale | <p>Kërkesë për:</p> <p>1. Shtesë prej 10 milion lekësh për Konferencën Europiane</p> <p>2. Shtesë 5 milion për shpenzime operative (602)</p> <p>3. 4 milion lekë shtesë për pajisje zyre;</p> <p>4. Shtesë 5 milion në investime për godinën(231)</p> <p>5. Shtesë strukture për dy punonjës.</p> | <p>Komisioni vendosi që të miratojë:</p> <p>1. Shtesë prej 8 milion lekësh për Konferencën Europiane.</p> <p>2. Shtesë 5 milion në investime për godinën(231)</p> |

| | | | |
|--------|---|--|---|
| 1 3 | Komisioni për Shërbimin Civil | Kërkoi të rakordohet fondi i pagave për një shtesë 3.7 milion lekë. | Komisioni vendosi të reflektohet shtesa për fondin e pagave në vlerën 3.7 milionë lekë. |
| 1 4 | Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi | -Shtesë 3 punonjës për zyrat lokale të Komisionerit (më parë fondi i pagave është mbuluar nga fondet IPA të Bashkimit Europian) | Duke qenë se vitin e kaluar ka pasur një shtesë prej tre punonjësish, që nuk është bërë aktive, Komisioni vendosi t'i rekomandojë komisionit përgjegjës që këta punonjës dhe fondi përkatës i pagave të kalojnë në zyrat rajonale. |
| 1 5 | Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit | Kërkesë që shpenzimet operative të jenë në nivelin e vitit të kaluar. | Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi dhe i rekomandon komisionit përgjegjës që për këtë institucion shpenzimet të jenë në nivelin 13 milionë lekë, si në buxhetin e vitit 2017, si dhe të bëhet aktive shtesa prej 4 punonjësish që është miratuar vitin e kaluar. |
| 1 6 | Këshilli i Lartë i Drejtësisë | Nuk ka paraqitur kërkesa shtesë | |
| 1 7 | Komisioni i Pavarur i Kualifikimit | Kërkohet shtesë në shpenzime në nivelin 17 milion lekë si vijon: -7.000.000 lekë për blerje pajisje elektronike; -9.000.000 lekë për orendi dhe pajisje zyre; -1.000.000 lekë për mobilim zyre dhe ambiente pune. | Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi shtesën në shpenzime, në vlerën 15 milion lekë , të ndara si më poshtë: - Orendi dhe pajisje zyre dhe mobilimi, shtohen 9 milion lekë - Blerje pajisje elektronike shtohen 6 milion lekë . |
| 1 8 | Kolegji i Posaçëm i Apelit | Kërkohen shpenzime kapitale shtesë në masën 45 milion lekë të detajuara si më poshtë: -Punime rikonstruksioni në vlerën 4 milion lekë. -Plotësim i nevojave të institucionit me kompjutera, skaner printera, sisteme elektrike në vlerën 10 milion lekë. -Pajisje dhe mobilje për zyra në vlerën 11 milion lekë. | Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi shtesën në shpenzime kapitale, në vlerën 30 milion lekë , të ndara si më poshtë: - Punime rikonstruksioni shtesë fondi 4 milion lekë ; - Pajisje kompjuterike shtesë fondi 8 milion lekë ; - Pajisje mobilimi dhe zyre shtesë fondi 8 milion lekë ; |

| | | | |
|--------|-----------------------------|--|--|
| | | <p>-Sistem regjistrimi audio-video, regjistrim audio i seancës gjyqësore në vlerën 6 milion lekë.</p> <p>-Sistem kontrolli dhe vëzhgimi elektronik 4 milion lekë.</p> <p>-Software për menaxhimin e çështjeve 4 milion lekë.</p> <p>-Automjet për plotësimin e nevojave për lëvizje administrative në vlerën 3 milion lekë.</p> <p>-Gjenerator elektrik 3 milion lekë.</p> | <p>- Sisteme regjistrimi audio-video, regjistrim audio i seancës gjyqësore shtesë fondi 5 milion lekë;</p> <p>- Software shtesë fondi 5 milion lekë.</p> |
| 1 9 | Komisionerët Publikë | <p>Kërkohet shtesë në zërin shpenzime kapitale, në masën 20 milion lekë të detajuara si më poshtë:</p> <p>-Punime rikonstruksioni në vlerën 2 milion lekë.</p> <p>-Plotësim i nevojave të institucionit me kompjutera, skaner, printera, sisteme elektrike në vlerën 7 milion.</p> <p>-Pajisje dhe mobilje për zyra në vlerën 6 milion lekë.</p> <p>-Software për menaxhimin e çështjeve në vlerën 2 milion lekë.</p> | <p>Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi shtesën në shpenzime kapitale, në vlerën 10 milion lekë, të ndara si më poshtë:</p> <p>-Punime rikonstruksioni në vlerën 0.5 milion lekë. -Pajisje elektronike shtesë fondi prej 3.5 milion lekë</p> <p>-Pajisje zyre dhe mobilimi shtesë prej 4 milion lekë</p> <p>-Software shtesë fondi 2 milion lekë.</p> |

- Të gjitha ndryshimet e miratuara më sipër nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të reflektohen në tabelën 1.1 të projektligjit.**